

Mitet lidhur me belbëzimin

Miti: Njerëzit që belbëzojnë nuk janë të menqur.

Realiteti: *Nuk ka asnjë relacion mes belbëzimit dhe inteligjencës.*

Miti: Neuroza shkakton belbëzimin.

Realiteti: *Neuroza nuk shkakton belbëzimin. Dhe as nuk mund të supozojmë se njerëzit që belbëzojnë janë të prirur të jenë nervoz, të druajtur,anksioz ose të turpshëm. Ata kanë personalitetin e tyre të plotë njësoj si ata që nuk belbëzojnë.*

Miti: Belbëzimi mund të “ngjitet” përmes imitimeve ose duke e dëgjuar një person që belbëzon.

Realiteti: *Belbëzimi nuk “ngjitet”. Askush nuk e di shkakun e vërtetë të belbëzimit, por hulumtimet e fundit tregojnë se historia familjare (gjenetika), zhvillimi neuromuskular, dhe ambienti i fëmijut, përfshirë dinamikën e familjes, të gjitha luajnë rol në paraqitjen e belbëzimit.*

Miti: Ndhmon që t’i tregojmë personit që “të marr thellë frymë para se të flas,” ose “të mendoj së pari para se të flas.”

Realiteti: *Kjo këshillë e bënë personin edhe më të vetëdijshëm, dhe e bënë belbëzimin edhe më të vështirë. Reagime më të dobishme përfshijnë të dëgjuarit me durim dhe duke modeluar vetë një të folur të ngadalshëm dhe të qartë.*

Miti: Stresi shkakton belbëzimin.

Realiteti: *Siç është cekur më lartë, janë të përfshirë shumë faktorë. Stresi nuk është shkaktar, por siguri mund të keqësojë belbëzimin.*



Shoqata Kosovare për Belbëzim

www.belbezimi.org



belbezimi